



Botschaft  
der Bundesrepublik Deutschland  
Pristina

## Konkurs 2017: Përkrahja e projekteve të vogla në kuadër të bashkëpunimit teknik

### Qëllimi i përkrahjes:

- ndihmë fleksibile, e shpejtë dhe efektive
- realizimi i nevojave bazike të shtresave të varfëra dhe shumë të varfëra të popullsisë

### Projektet që përkrahen janë projektet, të cilat:

- **nuk mund të vetëfinancohen** nga bartësit vendorë (p.sh. organizata joqeveritare apo grupe të vetëpërkrahjes).
- përmbajnë kontribut vetanak të bartësit, nxisin bashkëpunimin e popullsisë dhe që kanë **ndikim afatgjatë**.
- nuk e tejkalojnë **shumën e asistencës** prej 8.000,-€
- janë planifikuar ashtu që **të mos ketë shpenzime personale** (paga, rroga, honorare).
- nuk shkaktojnë obligime të vazhdueshme (p.sh. për nevoja të vazhdueshme për mallra konsumimi, si produkte foragjere, ilaçe, materiale etj.).
- janë për të mirën e sa më shumë njerëzve
- realizohen brenda vitit kalendarik 2017

**Nuk përkrahen individë apo ndërmarrje. Start-up për biznese janë gjithashtu të përjashtuara nga përkrahja financiare.**

### Procedura

Projektpropozimet duhet të dorëzohen me shkrim ose përmes email-it në Ambasadën Gjermane dhe duhet të përmbajnë të dhënat vijuese:

Në aplikacion duhet të shënohen:

- Bartësi i projektit
- Synimi i projektit
- Grupi i cakut
- Masat e planifikuara dhe ndikimi i tyre në grupin e cakut

Aplikacioni duhet nënshkruar nga dy bartës të projektit. **Nëse Aplikacioni dorëzohet përmes email-it nënshkrimet duhet të skenohen.**

Veç kësaj duhet të dorëzohen edhe këto dokumente shtesë:

- Financimi i projektit (vetëfinancim, financim nga pala e tretë, asistenca e kërkuar nga ambasada) në formë tabelare me vija përkatëse buxhetore
- 2 parallogaritje të shpenzimeve (oferta për materialin dhe shpenzimet e punës, gjatë realizimit të projektit, të përkthyer në gjuhën gjermane apo angleze)
- kopje të regjistrimit kosovar

Formularin për aplikim për projekte mund ta gjeni në faqen e internetit të Ambasadës Gjermane. Ju lusim që aplikimet Tuaja t'i dorëzoni **në gjuhën gjermane apo angleze** me të gjitha dokumentet e kërkuara dhe me dy nënshkrime deri më **28.02.2017**.

Me listën e përshtatur të kontrollit ju mund të kontrolloni, nëse i përmbushni kërkesat dhe nëse kërkesa juaj është plotësuar në bazë të formularit. Një listë kontrolli e plotësuar teresisht (ku të gjitha pyetjet e kan përgjigjien PO) nuk është garancion se projekt propozimi miratohet.

Evalrimi i projektit bëhet nga Ambasada Gjermane. Pas shqyrtimit dhe aprovimit të projektpropozimit me bartësin vendor lidhet një kontratë për asistencë.

Me kontratën e asistencës rregullohen të gjitha të drejtat dhe obligimet. Bartësi i projektit obligohet mbi të gjitha që të jap llogari për mjetet e pranuar. Me përmbylljen e projektit, duhet të dorëzohen faturat origjinale, me përkthimet përkatëse. Veç kësaj, bartësi i projektit pranon që projekti të promovohet nga ambasada.

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni Seksionin për Ekonomi dhe Bashkëpunim Ekonomik të Ambasadës Gjermane në Prishtinë. Ju lusim që mos të parashtroni pyetje shtesë për çështjet që janë të sqaruara në këtë informator. Për shkak të numrit të lartë të aplikimeve nuk mund të ofrohet këshillim individual.

#### **Kontakti:**

Ambasada Gjermane në Prishtinë

Seksioni për Ekonomi dhe Bashkëpunim Ekonomik

Rr. Azem Jashanica Nr. 17, Dragodan II

10 000 Prishtinë

TEL.: +381 (0)38 2545-00

FAX: +381 (0)38 2545-36

E-Mail: [info@pris.diplo.de](mailto:info@pris.diplo.de)